



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Teatri i Qytetit "Avdush Hasani" Podujevë

Datë: 28.01.2026

Nr. protokoli: 13/2026

Në bazë të Ligjit Nr.08/L-245 Për Artin dhe Kulturën, Neni 30, paragrafi 2 dhe paragrafi 4; Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", nr.01-640-93374, datë: 28.12.2016, neni 9, paragrafi 1.4; si dhe Rregullores për Punën e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", neni 1, paragrafi 5.2, dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", datë: 26.01.2026, nr. protokoli 12/2026, menaxhmenti i Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" shpall:

Thirrje Publike për Projekte Teatrore për vitin 2026 në Teatrin "Avdush Hasani"

Teatri "Avdush Hasani" në përputhje me këtë thirrje, fton regjisorët që të aplikojnë me propozim-projektet e tyre për realizimin e shfaqjeve me:

- Shfaqje për skenën e mbrëmjes – dramë/komedi me autor shqiptar/autor i huaj
- Shfaqje për skenën për fëmijë - autor shqiptar/autor i huaj

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim janë:

1. Regjisor i aplikon me platformë/ projekt skenik /vizion dhe ide (e nënshkruar nga regjisor)
2. Teksti i shfaqjes (të ketë të drejtat autoriale);
3. CV-ja e regjisorit
4. Tabela financiare (detaje të hollësishme rreth ekipës angazhuere dhe shpenzimeve financiare për realizimin e shfaqjes)
5. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës së aplikantit

Regjisori obligohet që të angazhojë trupën rezidente të Teatrit "Avdush Hasani". Vetëm në rast të mungesës së numrit të aktorëve, lejohet angazhimi i aktorëve nga jashtë. Projektet obligohen të realizohen brenda vitit 2026, në Teatrin "Avdush Hasani".

Projektet mund të dorëzohen fizikisht në Teatrin e Qytetit "Avdush Hasani", rruga "19 Qershori", në Podujevë, nga e hëna deri të premten (ora:09-15:00), ose në adresën zyrtare të email-it të menaxhmentit të teatrit: elhame.kutllovci@rks-gov.net.

Menaxhmenti i Teatrit "Avdush Hasani" do t'i paraqesë Këshillit Drejtues të Teatrit "Avdush Hasani" të gjitha propozim-projektet konkurruese për vlerësim dhe përzgjedhje të fituesve.

Propozim-projektet që nuk përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë thirrje, nuk do të shqyrtohen.

Afati për dorëzimin e projekteve është 15 dite punë, nga data: 28.01.2026 deri më: 18.02.2026.

Projektet të cilat dorëzohen pas këtij afati nuk do të pranohen!

Teatri "Avdush Hasani"



Elhame Kutllovci